



Pranuar / Dorezuar Received / Delivery	22-06	2023	3	with goal year
Organ / Istituta Organ / Institution Org. / Unit	Nr. Prot Pr. No.	Shitje e Pring Appendix	Sasia Kolicitua Quantity	
SKAMSHICK	4886/2023		114	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.783/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.783/2023 të datës 26.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike “kundërshtim i vlerësimit të rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.06.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

- I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa A.nr.783/2023 e datës 26.05.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. *Mbetet në fuqi* Formulari i datës 26.04.2023, për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, për ankuesin, lidhur me vitin 2022.

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 26.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër rivlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, me pretendimet ankimore së vlerësimi nga mbikëqyrësi i tij është jo i drejtë dhe tendencioz, që ka për qëllim degradimin e ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së janë plotësuar kushtet për pranushmërinë e ankesës siç përcaktohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4482/2023 e datës 26.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 i datës

26.04.2023; Vendimin A.nr.366/2023 të KPNSHCK-së; Emaillet e datës 26.04.2023 nga V.Sh për ankuesin; Emaillet e datës 26.04.2023 nga ankuesi për V.Sh; Emailin 27.04.2023 nga V.Sh për T.M; Ankesën me numër protokolli 1852/2023 e datës 16.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 i datës 19.01.2023; Formulari për planin individual të punës për periudhën janar-dhjetor 2022; Emailin e datë 14.01.2022 nga V.Sh për ankuesin; Emailin e datës 14.01.2023 nga U.Rr për V.Sh; Emailin e datës 14.01.2023 nga V.Sh për U.Rr; Shkresë për Planin Operativ vjetor në trajnimin e rasteve sipas Divizioneve në DMMB i datës 14.01.2022; Akt Emërimit AE.Nr.147/2022 i datës 31.12.2022 për ankuesin; Formularin për përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Kualitet Mbledhjen e Detyrueshme; Emailin e datës 12.07.2022, 08.07.2022 nga V.Sh për ankuesin; Emailin e datës 12.07.2022 nga ankuesi për V.Sh; Emailin e datës 08.07.2022 nga A.S për V.Sh; Emailin e datës 08.07.2022 nga N.G për A.S; Emailin e datës 04.02.2022 nga V.Sh për ankuesin; Emailin e datës 04.02.2022 nga U.Rr për V.Sh; Emailin e datës 04.02.2023 nga S.S për U.Rr; Emailin e datës 03.02.2023 nga I.M; Emailin e datës 03.02.2023 nga Sh.P për V.K; Emailin e datës 01.02.2022 nga N.H për S.S; Emailin e datës 01.02.2022 nga V.K për N.H; Emailin e datës 25.01.2022 nga N.H për Sh.P; Emailin e datës 25.01.2022 nga V.S për N.H; Emailin e datës 25.01.2022 nga I.I për ankuesin; Emailin e datës 25.01.2022 nga Xh.Gj për I.I; Emailin e datës 24.01.2022 nga ankuesi për Xh.Gj; Emailin e datës 24.11.2022 nga V.Sh për ankuesin; Emailin e datë 24.11.2022 nga ankuesi për V.Sh; Raporti mbi objektivat, veprimet, dhe përgjegjësi në Departamenti e Proceduarve në MD kualitetin e mbledhjes së Borxheve dhe Arka Fiskale për vitin 2022; Emailin e datës 17.01.2022 nga V.Sha për ankuesin; Shkresën mbi rastet e ndaka për Kualitet të Mbledhjes, në Divizionin e tretë të marrëveshjeve të lidhura e datës 17.01.2022; Emailin e datës 02.02.2022 nga ankuesi për V.Sh; Raportin e kualitet të rasteve të mbledhjes së detyrueshëm-Divizioni i 3 për marrëveshjet e lidhur i datës 02.02.2022; Emailin e datës 07.03.2022, 22.02.2022, 03.02.2022, 12.08.2022 nga ankuesi për V.Sh; Emailin e datës 02.03.2022, 07.02.2022, 02.02.2022, 03.08.2022 nga V.Sh për ankuesin; Shkresën e datës 03.08.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2114/2023 e datës 24.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2313/2023 e datës 03.03.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 18.01.2022, 06.01.2021; Akt Emërimit e datës 25.10.2019; Emailin e datës 02.03.2023 nga V.Sh për V.S; Raporti Javor i datës 28.01.2022; Vërejtje me shkrim e datës 01.11.2022; Raporti javor i datës 20.05.2022, 08.08.2022; Emailin i datës 10.08.2022, 09.08.2022 nga V.Sh për ankuesin; Emailin e datës 09.08.2022, 18.11.2022 nga ankuesi për V.Sh; Raporti javor i datës 19.09.2022, 16.09.2022, 18.11.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të kësaj çështje juridiko administrative, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës dhe së i njëjti sipas Akt Emërimit AE.Nr.147/2022 të datës 31.12.2022 është i punësuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Kualitet të Mbledhjes së Detyrueshme .

Udhëheqësi i Divizionit të Kualitetit të Mbledhjes në Administratën Tatimore të Kosovës në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit, më datë 19.01.223 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin lidhur me vitin 2022, duke e vlerësuar të njëjtin më notë të përgjithshme 2.80.



Ankuesi i pakënaqur me vlerësimin si me sipër, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.366/2023 të datë 03.04.2023 ka anuluar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 19.01.2023 dhe ka obliguar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të ankuesit, që të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022.

Duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit, Mbikëqyrësi i ankuesit me datë 26.04.2023, ka bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 për ankuesin, ashtu që të njëjtin e ka vlerësuar me notë të përgjithshme 2.84.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që vlerësimi është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punës dhe dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, dhe kundër vendimit të Këshillit, duke pretenduar më tutje se vlerësimi është tendencioz dhe i pa argumentuar pasi që nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë objektivat.

Kolegji në kuptim të vendosjes meritore i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 43 më të cilin përcaktohet se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë.. 6. Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime më nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuar për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim. 7. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi. 8. Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të. 9. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit... si dhe nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të paracaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues...".*

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, Kolegji ka analizuar provat e lëndës nga dhe ka konstatuar së ekziston Plani Individual i Objektivave të Punës për vitin 2022 i përgatitur në fillim (janar 2022) të këtij viti, vlerësimi i rezultateve në punë është bërë brenda afatit ligjore, vlerësuesi ka zhvilluar takim me ankuesin me qëllim të diskutimit të përmbushjes së objektivave

dhe aftësive të treguara në realizmin e objektivave si dhe vlerësimi i referohet objektiva të punës të përcaktuar sipas planit individual të punës.

Ndërlidhur si më sipër, e nga Formulari i datës 26.04.2023, vërehet fakti së mbikëqyrësi ka dhënë komente së në disa raste ankuesi nuk ka respektuar afatet për përmbushje të detyrave të punës dhe raportim si dhe mos respektim të orarit të punës, gjegjësisht ankuesi lidhur me pjesën e përmbushjes dhe realizmit të objektivave të punës është vlerësuar më notë 3.0, ndërsa lidhur me pjesën e aftësive dhe shkathtësive profesionale është vlerësuar më notë 2.60, ku nota e përgjithshme e vlerësimit për vitin 2022 është 2.84, e qe në vështrim të dispozitave të nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, nota përfundimtare e vlerësimit nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë", përkatësisht sipas këtij përcaktimi ligjor "mirë", vlerësohet nëpunësi civil i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës, kështu që, mbi këtë bazë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me vendosjen e notës së përgjithshme 2.8 për ankuesin, ka vlerësuar së i njëjti ka përmbushur të gjitha objektivat e punës.

Andaj, duke qenë së ankuesi më asnjë provë nuk ka arritur të dëshmojë që rivlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 është jo real dhe së i njëjti ka përmbushur detyra të cilat tejkalojnë planin e objektiva të përcaktuara, Kolegji i Këshillit mbi bazën e këtyre rrethana dhe fakteve konstaton së vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, dhe rrjedhimisht meqenëse ankuesi është vlerësuar mirë, të njëjtit nuk i janë cenuar të drejtat për ngritje profesionale dhe ngritje në karrierë, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Theksuar si më sipër, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.783/2023

Avdyl BEKTESHI

  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

